



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KUVENDI

Konferenca e Kryetarëve

PROCESVERBAL

Tiranë, më 20.01.2020, ora 10:00

Drejton mbledhjen:

Gramoz Ruçi – Kryetar i Kuvendit

Rendi i ditës:

1. Miratimi i projektprogramit të punës së Kuvendit për periudhën 20 janar – 6 mars 2020.
2. Miratimi i projektkalendarit 3-javor të punimeve të Kuvendit për periudhën 20 janar – 7 shkurt 2020.
3. Miratimi i kalendarit të paraqitjes në Kuvend të raporteve vjetore të organeve kushtetuese dhe atyre të krijuara me ligj për vitin 2019.
4. Miratimi i Planit Vjetor të Veprimit të Kuvendit për zbatimin e rekomandimeve të raportit të progresit të Komisionit Europian për Shqipërinë.
5. Shqyrtimi i kërkesës së një grupi prej 7 deputetësh për ngritjen e një komisioni të posaçëm.

Të pranishëm:

Gramoz Ruçi – Kryetar i Kuvendit

Vasilika Hysi - Zëvendëskryetare e Kuvendit

Myslim Murizi - Zëvendëskryetar i Kuvendit

Taulant Balla - Kryetar i Grupit Parlamentar të Partisë Socialiste

Nimet Musaj - Kryetar i Grupit Parlamentar të Pavarur

Ulsi Manja - Kryetar i Komisionit për Çështjet Ligjore, Administratën Publike dhe të

Drejtat e Njeriut

Mimi Kodheli - Kryetare e Komisionit për Politikën e Jashtme

Ermonela Felaj - Kryetare e Komisionit për Sigurinë Kombëtare

Niko Peleshi – Kryetar i Komisionit për Veprimtarinë Prodhuese, Tregtinë dhe Mjedisin

Enver Rroshi - Kryetare i Komisionit të Punës, Çështjeve Sociale dhe Shëndetësisë

Fatjona Dhimitri – Kryetare e Komisionit për Edukimin dhe Mjetet e Informimit Publik

Arlind Çaçini - Zëvendëskryetar i Grupit Parlamentarë Demokrat

Mungojnë:

Elisa Spiropali – Ministre për Marrëdhëniet me Parlamentin

HAPET MBLEDHJA

Gramoz Ruçi - Urime të gjithëve!

Një vit të mbarë!

Kjo është konferenca e parë që zhvillojmë për sesionin e ri parlamentar. Do të shikojmë miratimin e programit të punës së Kuvendit për periudhën 20 janar - 6 mars, miratimin e kalendarit trejavor të punimeve të Kuvendit për periudhën 20 janar – 7 shkurt, projektkalendarin e paraqitjes në Kuvend të raporteve të organeve kushtetuese dhe atyre të ngritura me ligj për veprimtarinë e tyre për vitin 2019, miratimin e planit vjetor të veprimtarisë së Kuvendit për zbatimin e rekomandimeve të Raportit të Progresit të Komisionit European për Shqipërinë, shqyrtimin e kërkesës së një grupi deputetësh për ngritjen e komisionit të posaçëm dhe njoftim për ecurinë e punës së projektit për mbështetjen e Kuvendit dhe edukimit qytetar.

Me draftprogramin dhe draftkalendarin besoj se jeni njohur në rrugë elektronike. Në

zbatim të draftprogramit është përgatitur draftkalendari. Programi përmban të gjitha çështjet që janë të depozituara në Kuvend. Këtu përfshihen çështjet që kanë qenë në procedurë parlamentare para se të mbyllet sesioni, si dhe çështjet që janë depozituar pas mbylljes së sesionit të kaluar.

Siç e keni parë edhe në programin që ju është dërguar, në Kuvend janë depozituar projektligje nga Këshilli i Ministrave, nga deputetë, akte normative në fuqinë e ligjit, dy interpelanca, çështja e zgjidhjes së inspektorit të lartë të drejtësisë, dekrete për rikthim ligji për shqyrtim, si dhe strukturën organike të Akademisë së Shkencave.

Gjithashtu, janë depozituar edhe dy kërkesa për ngritje të komisioneve të posaçme të cilat do t'i diskutojmë për vendim.

Draftkalendari përfshin veprimtarinë në komisionet e përhershme dhe në seancat plenare.

Janë parashikuar tri seanca plenare, përkatësisht në datat 20 janar, sot në orën 17:00, kur hapet sesioni i ri i parlamentit sipas rendit të ditës së parashikuar.

Seanca e dytë me 30 janar, në orën 10:00, sipas rendit të ditës së parashikuar. Interpelanca me ministrin e Brendshëm, që është kërkuar në këtë seancë, do t'i kalojë seancës pasardhëse, pasi ministri nuk ndodhet në Shqipëri për arsye pune dhe nuk mund të paraqitet në këtë datë.

Në draftkalendar është menduar e enjte, 6 shkurt 2020, ora 10:00 sipas rendit të parashikuar.

Kam mendimin, ta diskutojmë, nëse është e mundur seancën e datës 6 shkurt nga e enjtja, ta zhvillojmë të hënë në orën 10:00, pasi atë ditë është menduar, të paktën sipas komunikimeve që kemi deri tani, që Presidenti i Parlamentit Europian të vizitojë Shqipërinë dhe të mbajë edhe një fjalim në parlament. Pra, nuk kemi pse ta mbledhim parlamentin brenda javës dy herë, por të zhvillojmë seancën e të enjtes të hënë paradite dhe në orën 15:00 Presidenti i Parlamentit Europian do të marrë pjesë në Kuvend, ku do të përshëndesë Kuvendin.

A keni ndonjë sugjerim për programin dhe për kalendarin?

E dyta, kam edhe një problem tjetër lidhur me çështjen e zgjedhjes së Inspektorit të Lartë të Drejtësisë. Siç jeni në dijeni Këshilli i Emërimeve në Drejtësi i ka përcjellë Kuvendit listën me pesë kandidatë të përzgjedhur dhe të renditur mbi bazën e meritave. Në bazë të neneve 147, shkronja “d” të Kushtetutës dhe nenit 201, pika 2, shkronja “f” të ligjit nr. 115/2016 “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”, nëse Kuvendi nuk arrin shumicën

e kërkuar për asnjë prej kandidatëve brenda 30 ditëve nga paraqitja e listës, kandidati i renditur i pari shpallet i emëruar.

Ajo për të cilën kërkoj mendimin tuaj është kjo: afati plotësohet ditën e enjte, është dita e fundit, në mos gaboju?

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Data 25? Pra, do të kërkoja mendimin tuaj, nëse bien dakord që të kemi thjesht votim. Nëse është e mundur ta votojmë që sot. Sot deputetët janë prezentë, që të mos preokupohemi, vetëm për një votim ditën e enjte. Jemi të detyruar nga Kushtetuta dhe me ligj që brenda datës 25 ta mbyllim këtë çështje. Ju lutem për të dyja këto kërkoj mendimin tuaj për programin dhe kalendarin me dy sugjerimet që ju bëra: për seancën e datës 6, që të bëhet në datën 3 dhe për zgjedhjen e Inspektorit të Lartë të Drejtësisë.

Fjala është për ju.

Po, zoti Manja.

Ulsi Manja - Përsëndetje të gjithëve!

Sesion të mbarë parlamentar!

Lidhur me programin e punës së Kuvendit, në faqen 3, pika 9 propozoj që të hiqet nga programi i punës së Kuvendit raporti vjetor i Këshillit të Ministrave “Për zbatimin e politikave në shërbimin civil për vitin 2018”, sepse në Komisionin e Ligjeve raportoi zëvendëskryeministri u bë gati edhe projektrezoluta, por duke qenë se nuk pati raportim në Kuvend, nuk u miratua as rezoluta për veprimtarinë e administratës publike për vitin 2018. Sot do të miratojmë kalendarin e ri të raportimeve të institucioneve kushtetuese dhe të krijuara me ligj dhe nuk ka logjikë. Zëvendëskryeministri, qeveria do të vijë të raportojë për vitin 2019, kështu që s’ka pse të ngelet në kalendar raportimi për vitin 2018. Pra, le të hiqet nga programi, dhe të raportohet për të dy vitet në komisione e më pas në seancë plenare.

E dyta, zoti kryetar, do të kërkoja në mënyrë të vazhdueshme, jo vetëm për këtë program të punës së Kuvendit, po për të gjitha programet që do të kalojnë në Konferencën e Kryetarëve për këtë sesion parlamentar, që në zbatim të Kushtetutës, nenit 121 të Kushtetutës, të gjitha marrëveshjet ndërkombëtare dhe ratifikimet e konventave ndërkombëtare të kalojnë nëpërmjet Komisionit të Ligjeve.

Sipas Kushtetutës, çdo marrëveshje ndërkombëtare apo çdo konventë që ratifikohet, bëhet pjesë e të drejtës së brendshme dhe ka epërsi ndaj ligjeve të vendit, ndaj është krejt e natyrshme që Komisioni i Ligjeve, qoftë si komision përgjegjës apo si komision për dhënie mendimi, do të duhet të shprehet si komision në lidhje me përputhshmërinë që këto

marrëveshje dhe konventa ndërkombëtare kanë me Kushtetutën. Kjo le të jetë në mënyrë të vazhdueshme pjesë e çdo programi dhe çdo kalendari të punimeve të Kuvendit.

Këto kisha për sa i përket programit të punës së Kuvendit.

Lidhur me pikën e dytë, atë që ju shtruat për diskutim, sa i takon zgjedhjes nga Kuvendi të Inspektorit të Lartë të Drejtësisë, unë jam dakord me atë që ju propozoni. Do ti kërkoja Konferencës së Kryetarëve, që sot, në seancë plenare, ta përfshijmë si pikë të rendit të ditës zgjedhjen e Inspektorit të Lartë të Drejtësisë, duke marrë të mirëqenë vendimin nr. 154, datë 23, 12, 2019 të Këshillit të Emërimeve në Drejtësi, i cili ka miratuar listën përfundimtare të renditjes së kandidatëve, së bashku me raportin përkatës. Kjo sepse data 25 janar 2020 është afati i fundit limit, pra afat prekluziv, brenda të cilit Kuvendi i Republikës së Shqipërisë do të duhet të ushtrojë të drejtën e vet kushtetuese për të zgjedhur Inspektorin e Lartë të Drejtësisë.

Nëse Kuvendi nuk e ushtron këtë të drejtë, bazuar në ligjin “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë” dhe në Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë... Pra, më saktë, ky është një përcaktim kushtetues, i shprehur qartë në nenin 147 të Kushtetutës, e më pas edhe në ligjin organik, që është ligji “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”, dhe nëse Kuvendi nuk e ushtron brenda 30 ditëve, kandidati i renditur në listë quhet automatikisht i zgjedhur si Inspektor i Lartë i Drejtësisë.

Unë propozoj që, me vendim të Konferencës së Kryetarëve, të përfshihet sot në rendin e ditës zgjedhja e Inspektorit të Lartë të Drejtësisë, dhe Kuvendi të marrë të mirëqenë vendimin e Këshillit të Emërimeve në Drejtësi e raportin përkatës. Kjo në mënyrë që të mos ia heqim Kuvendit të drejtën e ushtrimit të kësaj kompetence kushtetuese.

Niko Peleshi – Zoti kryetar,

Të nderuar anëtarë të konferencës,

Lidhur me programin kam vetëm një vërejtje për pikën 34 të programit. Bëhet fjalë për projektligjin “Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr. 8561, datë 22, 12, 1999 “Për shpronësimet dhe marrjen në përdorim të përkohshëm të pasurisë pronë private për interes publik”.”

Komisioni i Veprimtarive Prodhuese është caktuar si komision përgjegjës, ndërsa Komisioni për Çështjet Ligjore, si komision për dhënie mendimi. Besoj se duhet të jetë e kundërta, sepse nuk është një çështje që na përket neve si komision përgjegjës, sipas gjykimit tim. Më shumë është një çështje ligjore, një amendament ligjor.

Për sa u përket dy propozimeve të tjera, edhe unë mendoj si zoti Manja, që bëjnë sens. Sot të kalojmë në votim, në respektim të detyrimeve kushtetuese, për Inspektorin e Lartë të Drejtësisë.

Natyrish, është i arsyeshëm edhe propozimi juaj për të afruar seancën plenare të datës 6 në datën 3.

Faleminderit!

Vasilika Hysi – Faleminderit, zoti Kryetar!

Lidhur me projektprogramin e punës së Kuvendit, në vijim të atyre që tha edhe kolegu Manja, kam një sugjerim për projektligjin “Për të huajt”. Kur është miratuar ky projektligj, Komisioni i Ligjeve ka qenë komision përgjegjës. Normalisht, Komisioni i Ligjeve duhet të jetë i përfshirë si komision përgjegjës ose si komision për dhënie mendimi, pasi nuk figuron në asnjë nga këto dy pozicione.

Së dyti, të njëjtin sugjerim, që ishte për pikën 49, e kam edhe për pikën 54 të planit, ku flitet për ligjin për gardën dhe SHÇBA-në. Janë ligje që janë diskutuar dhe Komisioni i Ligjeve ka qenë pjesë e miratimit të tyre. Mund të jetë edhe një komision për dhënie mendimi, për të parë përputhshmërinë me ligjet e tjera dhe me të drejtat.

Së treti, në këtë program ka shumë projektligje, të cilat po transferohen nga një sesion plenar në një sesion tjetër, disa lidhen edhe me legjislaturën. Ndoshta do të ishte mirë që drejtoria përkatëse të japë një argument pse mbarten, pasi rezulton se që nga viti 2017 kemi ende ligje, që qëndrojnë në kalendar. Shumica janë nisma deputetësh dhe nëse deputetët nuk i tërheqin, atëherë le të shqyrtohen, të miratohen ose të rrëzohen, por nuk mund të dalë që Kuvendi për tri vjet nuk është në gjendje të diskutojë nisma të cilat kanë nga një nen të veçantë. Në këtë kuadër, do të sugjeroja që kalendarin tjetër të pastrohet, sepse nuk është në dinjitetin e Kuvendit.

E fundit fare për këtë pjesë. Në bazë të ndryshimeve në Rregullore, ministria e Shtetit për Marrëdhëniet me Parlamentin duhet t’i depozitojë Kuvendit të Shqipërisë kalendarin e të gjitha projektakteve që priten të depozitohen. Nëse ky kalendar ka ardhur është mirë t’u vihet në dispozicion kryetarëve të komisioneve, me qëllim që të hartohet kalendarin i veprimtarive të kontrollit parlamentar (që e ka me detyrim çdo komision), në bazë të ndryshimeve që janë bërë vjet në Rregullore, por edhe për të bërë një shpërndarje të ngarkesës dhe angazhimit të deputetëve nëpër komisione.

Faleminderit!

Enver Roshi – Komisioni i Shëndetësisë ka dy projektligje, projektligjin “Për ndryshime dhe shtesa në ligjin nr. 9942, 26.06.2008 “Për parandalimin e çrregullimeve të shkaktuara nga pamjaftueshmëria e jodit”, të cilin kërkoj të shtyhet, sepse nuk do të jem, do të jem jashtë, dhe meqë është një ligj i rëndësishëm së veçantë, kërkoj të shtyhet një javë më vonë,

si dhe projektligjin “Për pranimin e instrumentit të amendamentit të Kushtetutës së Organizatës Botërore të Punës”, që është në bashkëpunim me komisionet e tjera. Nëse është e mundur të shtyhet për një javë më vonë, me qëllim që t’i jepet kohë komisionit ta shqyrtojë.

Faleminderit!

Myslim Murrizi – Faleminderit, zoti Kryetar!

Edhe unë, duke mbështetur diskutimin e zonjës Hysi, kam disa rezerva për kalendarin e 6-mujorit të dytë të vitit që shkoi, ku kam parë të rreshtuara disa projektligje, të cilat shtyhen pa asnjë lloj shkak. Një prej tyre është ligji për gjuetinë. Ulsi qesh, por gjuetia nuk u mbyll se ju dhimbsen rosat, por sepse do të mbillej drogë nga kampioni. Meqë këmba e gjahtarit shkel kudo e mbaruat atë mision. Po vriten njerëzit në mes të Tiranës çdo ditë, ja ku është Blloku, kurse juve ju dhimbsen rosat e egra dhe shkurtëzat. Nëse keni interes, nga informacioni që kam, një deputeti juaj ka qejf të krijojë një shoqatë me italianët. Ta bëjë pas ligjit. Boll i keni torturuar ata se paguajnë kuotat. Ose mos e fusni fare të ky kalendar, mos u tallni!

Kështu keni zvarritur pafundësisht projektligje që janë nisma deputetësh, duke i dhënë prioritet qeverisë. Unë nuk dua të merrem *non stop* me atë punë, por nuk kishit pse ta shtynit 6 muaj një projektligj për festat zyrtare. Tërhiq e zvarrit. Nesër do të jemi të gjithë në Lushnjë dhe do të ishte mirë ta kishim kryer atë votim në Kuvend për ta shpallur festë zyrtare 21 janarin e vitit 1920 të Kongresit të Lushnjës. Nuk e di pse hezituat dhe tani e keni futur bashkë me kërkesën e një deputeti, që kërkon që Krishtlindjet të jenë në 7 janar.

Në lidhje me përafrimin e datës 3 jam absolutisht dakord, për votimin e Inspektorit të Lartë të Drejtësisë, Kuvendi e ka përjashtuar vetë me ligj. Pra, kur Kuvendi ka miratuar reformën në drejtësi, ka thënë se nëse ne nuk do të jemi në gjendje, ata burrat do ta zgjedhin vetë këtë punë. Kështu, në një farë mënyre ky është akt formal dhe mund ta kishit shtuar edhe në rendin e ditës. Ai është i zgjedhur, sepse e ka zgjedhur KED-ja, ndaj, si e votuat ju sot, si nuk e votuat ju, e keni kryer atë punë me Dvoranin. Kështu, për mua nuk ka asgjë të keqe, për të mos mbetur në heshtje sikur ne po i shmangemi detyrës kushtetuese që i ngarkohet Kuvendit me ligjin e ri të drejtësisë, ndaj le të futet dhe të votohet tek ajo. Pra, edhe nëse nuk votohet sot, në datën 30, kur ne të mblidhemi, ai është emëruar vetë. Ajo që dua të shtoj, jashtë kalendarit, por besoj brenda tagrit të parlamentit, të Konferencës së Kryetarëve, është se unë kam këtu një listë të institucioneve të pavarura, të cilat emërohen të gjitha nga Kuvendi.

(Diskutime pa mikrofon)

Këtu janë 23 vende bosh dhe unë nuk e di pse janë.

(Ndërhyje pa mikrofon)

Do të flasim sot për këto? Dakord!

Faleminderit!

Nimet Musaj - Faleminderit, Kryetar!

Unë dua t'u uroj të gjithë kolegëve suksese për këtë legjislaturë! Vendin tonë e presin sfida të mëdha, duke filluar nga muaji mars e në vazhdimësi, sepse janë disa procese shumë të rëndësishme, për të cilat ne duhet të japim kontributin tonë, në mënyrë që vendi ynë të arrijë objektivat që ka. Normalisht, duhet të futet sot në rendin e ditës zgjedhja e inspektorit të Lartë të Drejtësisë dhe jam dakord që seanca e datës 6 shkurt të afrohet në datën 3 shkurt.

Faleminderit!

Fatjona Dhimitri – Faleminderit, zoti Kryetar!

Lidhur me projektkalendarin, deri diku është përcaktuar edhe data për dekretin e Presidentit të Republikës lidhur me “Paketën antishpifje”, ndaj mendoj se duhet të shqyrtohet në komisionet parlamentare. Meqenëse këtu kemi edhe përfaqësuesit e maxhorancës, unë nuk po e diskutoj datën e diskutimit, sepse nuk e di se sa gati janë për ta shqyrtuar dekretin, por thjesht po ju bëj edhe një herë thirrje se ky dekret duhet të diskutohet në komisionin parlamentar.

Së dyti, u bëj thirrje edhe një herë që të mos e ndjekim modelin inatçor, duke i rrëzuar dekretet e Presidentit. Pra, t'i shqyrtojmë edhe një herë në themel këto dekrete nëse e cenojnë apo jo lirinë medias.

Faleminderit!

Ulsi Manja – Në projektkalendar kemi shqyrtimin e dy nismave të kolegëve deputetë: projektligjin “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese në Republikën Shqipërisë” të ndryshuar”, si dhe projektligjin “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”. Këto dy projektligje janë planifikuar për seancën e datës 30 janar. Meqenëse seanca e datës 6 shkurt do të afrohet në datën 3 shkurt këto dy projektligje nuk bëhen dot gati për seancën e datës 30 janar. Komisioni i Ligjeve mund të bëjë gati për seancën e datës 3 projektligjin “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese në Republikën Shqipërisë”.

Lidhur me projektligjin “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, përveç ndryshimeve që kanë kërkuar deputetët me nismë, Këshilli i Lartë Gjyqësor dhe Këshilli i Lartë i Prokurorisë kanë depozituar edhe disa kërkesa të tjera, në bashkëpunim edhe me misionin EURALIUS dhe OPDAT, që kërkojnë të adresohen në ligjin

“Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”. Unë kërkoj që këtë projektligj ta planifikojmë për seancën e datës 3 shkurt dhe më pas në dinamikë mund të shikojmë nëse do ta mbyllim brenda kësaj date. Ndërsa lidhur me projektligjin për Gjykatën Kushtetuese unë kërkoj që të shtyhet për në datën 3 shkurt.

Taulant Balla - Së pari, besoj se Konferenca e Kryetarëve, në frymën e ligjit dhe të Kushtetutës, e pranoi propozimin e Kryetarit të Kuvendit për të votuar në seancë plenare Inspektorin e Lartë të Drejtësisë, në respekt të afatit që i është vendosur Kuvendit, por edhe në frymën e ligjit. Ndoshta këtu duhet të kujtojmë se Rregullorja është e padakordësuar me ligjin. Këtë gjë dua t’ua bëj të ditur organizatave që monitorojnë Kuvendin dhe që pa të drejtë e kanë kritikuar Kuvendin për këtë çështje për sa kohë që një seancë dëgjimore apo një proces rekrutimi i kandidatëve bëhet për muaj me radhë në institucionet e pavarura të ndërtuara me ligj, Kuvendi shprehet dhe duhet të shprehet vetëm përmes vendimit të seancës plenare. Prandaj propozimi juaj dhe i kryetarit të Komisionit të Ligjeve, i mbështetur edhe nga nënkryetari i Kuvendit, si përfaqësues i opozitës, zoti Murrizi, gjen vend dhe besoj se është arsyetimi më i saktë që ne duhet të bëjmë sot në seancë plenare

Lidhur me programin, kam disa sugjerime. Për pikën 3, që bën fjalë për përfundimin e proceseve kalimtare të pronësisë në Republikën e Shqipërisë, zoti Murrizi me të drejtë theksoi që janë disa projektligje që mbarten pafundësisht, ndërkohë që ju kujtoj se kjo ka qenë një çështje e rendit të ditës, prandaj edhe kjo të planifikohet në seancën e datës 3 shkurt. Kujtoj këtu që komisionet përkatëse e kanë përmbyllur punën e tyre, prandaj, nëse qeveria ka komente për këtë, të marrë kohë deri në datën 3 shkurt, kur Kuvendi duhet ta planifikojë për ta shqyrtuar.

Në vijim të propozimit të kryetarit të Komisionit të Ligjeve, zotit Manja, bashkë me heqjen e raportit vjetor të Këshillit të Ministrave, për zbatimin e politikave në shërbimin civil, pra pika 9, të hiqet edhe raporti i veprimtarisë vjetore të Kontrollit të Lartë të Shtetit për vitin 2018. Ndërkohë, ngelemi me shpresën që në vitin 2020 ne të kemi ndërmarrë hapat e nevojshëm për zgjedhjen e ngërçit të krijuar për drejtimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit, po ashtu edhe për raportin, dhe ai raport të jetë një prezantim 2-vjeçar i punës së këtij institucioni.

Pika 12, projektligji “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 10 242, datë 25.02.2010, “Për Institutin e Studimeve për Krimet dhe Pasojat e Komunizmit në Shqipëri” ka mbetur pezull, por unë mendoj që të bashkohet me pikën 31, e cila është e njëjta nismë. Pra, kemi të njëjtën nismë të depozituar në dy data të ndryshme, njëra është propozim nga një grup prej 10 deputetësh, ndërkohë që nisma tjetër është propozim nga një grup prej 2 deputetësh, nga zoti Shameti dhe zoti Hyseni. Kjo të planifikohet, pasi të jetë përfunduar nga komisioni përgjegjës, të futet në seancë plenare.

Edhe pika 16, projektligji “Për parandalimin e çrregullimeve të shkaktuara nga pamjaftueshmëria e jodit në organizmin e njeriut”, siç e tha edhe kryetari i komisionit, ju lutem, nëse nuk do të shqyrtohet në datën 3, atëherë të shqyrtohet në javën e tretë të shkurtit në mënyrë që Kuvendi të mos ketë nisma ligjore të pashqyrtuara.

Pika 25, u tha këtu me të drejtë nga nënkryetari i Kuvendit, zoti Murrizi, por edhe këtu kemi 2 nisma me të njëjtën objekt, pra është njëjti ligj edhe në pikën 47. Pra pika 25 dhe pika 47 të bashkohen. Për fat të mirë kanë ardhur edhe komentet e institucioneve të tjera, si, Akademia e Shkencave e të tjera. Unë mendoj që ligji për festat zyrtare dhe ditët përkujtimore në Republikën e Shqipërisë, është në nderin e Kuvendit të ketë një rishikim të plotë me qëllim që të shmangim disa problematika të trashëguara ose përdorimi i ligjit për festa zyrtare dhe ditët përkujtimore të mos jetë një çështje personale e një grupi apo e një njeriu, të jetë një qasje e përbashkët e të gjithë anëtarëve të Kuvendit.

Pra, pika 31 të bashkohet me pikën 12, ndërkohë që edhe pika 47 të bashkohet me pikën 25. Këto janë çështjet që kisha për pikën 3 të rendit të ditës.

Faleminderit!

Ermonela Felaj – Faleminderit!

Pika 53 e programit, projektligji “Për dhënie amnistie”, duhet t’i kalojë për dhënie mendimi edhe Komisionit të Sigurisë. Unë nuk po jap ndonjë argument tjetër, por mjafton t’ju kujtoj se në 10 vjetët e fundit çdo ligj i ngjashëm për amnistinë ka kaluar edhe në Komisionin e Sigurisë Kombëtare.

Gramoz Ruçi – Atëherë, të gjitha propozimet për të parë ligjet në komisionet përkatëse, që paraqitën zoti Manja, zoti Peleshi, zonja Hysi, zoti Murrizi, zoti Balla dhe zonja Felaj, të rishikohen në program dhe në kalendar.

E dyta, lidhur me problemin që u ngrit për ligjet e bartura 3-vjeçare, të shikohet rruga sipas Rregullores për heqjen, diskutimin, kalimin në seancë, miratimin ose jo, por të ketë një përgjigje, sepse nuk mund të vazhdojnë të barten.

Për sa u përket festave zyrtare, ku zoti Murrizi me të drejtë ka marrë nismën dhe ka bërë vërejte edhe mbledhje tjetër të Konferencës, duhet ta rishikojmë në tërësi dhe në kompleks të gjithë ligjin që ka të bëjë me festat zyrtare në Shqipëri, çfarë do të quhet, çfarë nuk do të quhet, për ta parë edhe një herë nga fillimi.

Do të ftoja forcat politike të japin kontributet e tyre për këtë çështje!

E mbyllim këtë çështje të programit.

Kalojmë te çështja e kalendarit të raportimit të institucioneve kushtetuese dhe atyre të krijuara me ligj, që bartin detyrimin për të raportuar në Kuvend për veprimtarinë e vitit të kaluar.

Projektkalendari është përgatitur nga Shërbimi i Monitorimit të Institucioneve.

Çfarë vërejtje keni?

Urdhëroni, zonja Hysi!

Vasilika Hysi – Faleminderit, zoti Kryetar!

Unë kam një sugjerim lidhur me kalendarin, duke pasur parasysh edhe përvojën e viteve të shkuara.

Për shumicën e institucioneve që raportojnë në Kuvend jepet afati maksimal brenda të cilit duhet të raportojë institucioni, por askush nuk ndalohej për ta bërë raportimin më herët. Do t'ju sugjeroja, këtë e kam për shërbimin e monitorimit, që t'i mbledhin sa më shpejt raportet e institucioneve dhe të mos i lënë në periudhën prill, maj, qershor, e cila është mjaft e ngarkuar për Kuvendin dhe aspak e dobishme për t'i shqyrtuar në seancë plenare, për të përgatitur rezolutën dhe për t'u dhënë kohë institucioneve të zbatojnë rezolutat që miraton Kuvendi i Shqipërisë. Kjo i bie të jetë totalisht formale, pasi ne u lëmë institucioneve të pavarura 2 deri në 3 muaj maksimumi në dispozicion për të zbatuar një rezolutë të Kuvendit të Shqipërisë.

Pra, të planifikohet që në këtë periudhë të bëhet paraqitja, mbrojtja dhe më pas prezantimi sa më shpejt në seancë.

E dyta, kam një sugjerim lidhur me kontrollin parlamentar. Meqenëse metodologjia e kontrollit ka ndryshuar, njëkohësisht kur të shqyrtojmë pikën tjetër të rendit të ditës në kalendar BE-ja ka kërkuar të kemi një qasje më konkrete të kontrollit parlamentar të institucioneve të pavarura t'u bëhet edhe një herë e ditur të gjitha institucioneve që të bëjnë një raportim standard, sipas rekomandimeve dhe udhëzimit që është përgatitur në dhjetorin e vitit 2018. Shumë herë raportet janë voluminoze dhe nuk japin informacion për atë çfarë ne kërkojmë në bazë të Rregullores, aq më tepër që Rregullorja ka ndryshuar gjatë vitit të kaluar.

E fundit, do t'ju sugjeroja, meqenëse kemi një samit në të cilin do të shqyrtohet edhe një herë pozicioni që do të mbajnë vendet e BE-së në raport me Shqipërinë dhe Maqedoninë e Veriut, një nga pikat e raportprogresit të vitit 2019 është pikërisht roli i Kuvendit dhe i mekanizmit në lidhje me këto institucione. Këtë fakt ta mbajmë në konsideratë në mënyrë që Kuvendi në këtë periudhë të jetë aktiv dhe të dijë çfarë të raportojë dhe të mos të dalim me aktivitete të porealizuara, siç kemi dalë me planin, i cili është pika tjetër e rendit të ditës.

Faleminderit!

Ulsi Manja – Faleminderit, zoti Kryetar!

Në përgjithësi projektkalendari i raportimit të organeve kushtetuese dhe atyre të ngritura me ligj për veprimtarinë e tyre për vitin 2019 merr në konsideratë afatet ligjore, për secilin institucion të parashikuara në ligjet e tyre organike në vlerësimin tim është korrekt.

Lidhur me metodologjinë e raportimit, ka një manual të miratuar me vendim të Kuvendit që ka standardizuar mënyrën e raportimit të këtyre institucioneve. Jam dakord me kolegen Hysi, gjë që e kemi diskutuar edhe me shërbimet e Kuvendit, që këtë vit në metodologjinë e raportimit të institucioneve kushtetuese dhe të pavarura t'i kërkohej secilit prej këtyre institucioneve edhe anekset lidhur me treguesit e matshmërisë të zbatimit të rezolutave të Kuvendit. Nga eksperiencia që kishim vjet do të duhet që drejtuesve të këtyre institucioneve t'u bëhet e qartë që raportimi në komisionet përkatëse e më pas në seancë plenare të respektojë kohën e përcaktuar në manual dhe ky raportim të fokusohet te zbatimi i rezolutave që ka miratuar Kuvendi për secilin nga këto institucioneve.

Vjet është respektuar me korrektësi ky kalendar dhe po ashtu kemi rënë dakord edhe për sivjet, pavarësisht afateve që janë fiksuar në ligjet e tyre organike, nëse institucionet i sjellin në kohë ose para afatit raportet e tyre ato të përfshihen menjëherë në kalendarin e punës së komisioneve, pra nuk do t'u rrimë strikt afateve që janë përcaktuar. Supozojmë, në rast se komisioneri për Mbrojtjen e të Dhënave Personale e ka për të raportuar në muajin maj dhe e sjell raportin në muajin mars apo prill ky raportim menjëherë të bëhet pjesë e punës së komisioneve përkatëse.

Kam disa propozime konkrete lidhur me kalendarin e raportimeve. Në fakt, pjesa dërrmuese e institucioneve kushtetuese dhe të krijuara me ligj që raportojnë në Kuvendin e Shqipërisë janë në fushën e përgjegjësisë së Komisionit të Ligjeve, në mos gaboj janë 13 apo 14 institucione. Lidhur me pikën 3, Prokurori i Përgjithshëm. Sipas ligjit organik Prokurori i Përgjithshëm raporton në Komisionin për Çështjet Ligjore. Vjet pati një propozim në Konferencën e Kryetarëve, që komision përgjegjës të ishte edhe Komisioni për Sigurinë Kombëtare, por në fakt, Institucioni i Prokurorit të Përgjithshëm do të duhet të raportojë; komision përgjegjës do të duhet të ngelet Komisioni i Ligjeve dhe asnjë nga deputetët e komisioneve të tjera nuk pengohet që të jetë pjesë e dëgjësës publike qoftë të Prokurorit të Përgjithshëm apo të çdo drejtuesi të institucioneve të tjera, por të mbetemi te ligji organik.

E dyta, propozoj të shtohet Avokatura e Shtetit, se nuk e shoh në kalendar. Avokatura e Shtetit, referuar ndryshimeve të fundit që u bënë, në nenin 19/9 raporton në Komisionin përkatës të Ligjeve vetëm për sa i përket zbatimit të vendimeve të Gjykatës Europiane të të

Drejtave të Njeriut; nuk dilet me rezolutë, por raporti që miraton Komisioni i Ligjeve bëhet publik në faqen e Kuvendit. Ka raportuar vjet, por propozoj të shtohet edhe në kalendarin e raportimit të institucioneve. Nuk është organ kushtetues, por është organ i krijuar me ligj, që raporton në Komisionin e Ligjeve.

E treta, lidhur me Inspektorin e Lartë të Drejtësisë, pavarësisht se do ta zgjedhim sot atë, ligji ka parashikuar një periudhë 6-mujore për ta ngritur si institucion, i cili raporton në Kuvend jo më pak se 1 herë në vit. S'ka asgjë që të përfshihet edhe Inspektori i Lartë i Drejtësisë në projektkalendarin e raportimeve të institucioneve kushtetuese.

Kam një propozim për Konferencën e Kryetarëve në lidhje me pikën 22, që është Komisioni i Prokurimit Publik. Në fakt, ky Komision, le të themi se është Gjykata e Prokurimeve Publike, është Agjencia e Prokurimit Publik dhe në instancë të dytë, instancë apeli, apo gjykata që vendos për prokurimet publike është Komisioni i Prokurimit Publik, i cili shqyrton zbatimin e ligjit për prokurimet publike nga ana e agjencive publike. Le të themi është një gjykatë ligji dhe do të ishte e udhës që ky komision të raportojë në Komisionin e Ligjeve, aq më tepër që Komisioni i Ligjeve ka në përbërje edhe tri nënkomisione: Nënkomisionin për të Drejtat e Njeriut, Nënkomisionin për Administratën Publike, po ashtu ka edhe Nënkomisionin për Pushtetin Vendor dhe qoftë administrata, qoftë pushteti vendor janë institucione që punojnë me ligjin e prokurimit publik. E kam kërkuar edhe vjet këtë, por Konferenca e Kryetarëve nuk e mori në konsideratë propozimin tim, ndaj do të kërkoja sërish mirëkuptimin e kësaj Konference, që ky institucion të raportojë në Komisionin e Ligjeve.

Këto kisha lidhur me kalendarin.

Myslim Murrizi – Së pari, nuk e di çfarë problemi teknik apo ligjor mund të ketë që Prokurori i Përgjithshëm të vijë të raportojë në Komisionin e Sigurisë Kombëtare, derisa puna e Prokurorit të Përgjithshëm është e lidhur pazgjidhshmërisht si me Ministrinë e Brendshme, ashtu edhe me Shërbimin Informativ Kombëtar, të cilët raportojnë aty. Vitin që shkoi ne ishim bashkë të dyja komisionet me prokurorin, dhe besoj se përveç Komisionit të Ligjeve nuk ka ku të raportojë tjetër përveçse te Komisioni i Sigurisë Kombëtare. Nuk e di çfarë përplasje ka.

Kemi jo pak institucione kushtetuese që raportojnë në tri komisione njëherësh. Nuk e di çfarë monopoli keni.

Ajo që do të doja të shtoja në fillim të fjalës sime, ishte që unë kam një listë këtu me 105 individë të zgjedhur nga Kuvendi nga institucionet kushtetuese. Sot që flasim 20 individëve u ka mbaruar mandati prej kohësh, pra 20 % e këtyre institucioneve kushtetuese janë bosh, 2 prej të cilëve i ka Presidenti i Republikës, kryetarin e Kontrollit të Lartë të Shtetit,

(nuk besoj që të kemi luksin si shtet në këtë lloj përbaltjeje me njëri-tjetrin, hajdutllëku këtu, korrupsioni atje, kush i kontrollon, ta lënë vend vakëf, nuk e di pse, ndoshta nuk ju pëlqeu Vitorja ose ai tjetri). Duhet detyruar t'i çohet shkresë Presidentit edhe për KLSH-në, edhe për Eduard Ypin, që ka 6 muaj që i ka mbaruar mandati tek Autoriteti i Konkurrencës. 5 vetë ka gjithsej dhe, për hir të së vërtetës, 72 çështje ka shqyrtuar vitin që shkoi. Shoh që nga Saimir Kumbaro, të gjithë KRTRSH-së dhe KDRTRSH-së me Pashk Përvathin, Artan Peqinin, Xhemal Maton, Albana Sulçen, Elidon Halitin, Xhelil Aliun, Vladimir Groshin, Gentjan Salën, Les Gjepalin, Pirro Mishën, Zylyftar Bregun, Eduardi që ju thashë, Bujar Leskajn, u ka mbaruar mandati. Pse duhet t'i lëmë? Çfarë institucioneve kushtetuese janë këto kur 1/5-ta e tyre është bosh? Ju i keni votat, bini në konsensus, çojini letër atij. Besoj e mbaruat periudhën e zemëratës. Ulsi, a u pajtuat me Metën? Ose pajtohuni tamam dhe thoni t'i sjellë, ose futini "objekt hetimor" se shkelje kushtetuese është ajo që ka lënë vendin 2 vjet pa kryetar KLSH-je.

Unë besoj se Kuvendi duhet të kryejë detyrën e tij kushtetuese deri sa jemi republikë parlamentare dhe parlamenti prevalon mbi të gjitha.

Ju, burra dhe gra, që jeni këtu, hapni konkurrimet në komisionet përkatëse që të plotësohen vendet vakante!

Faleminderit!

Gramoz Ruçi – ...nuk ka.

Dy gjëra do të thosha lidhur me problematikën që ngriti zonja Hysi dhe zoti Manja. Të dyja mbulonin njëra-tjetrën, manuali është ku përcaktohet çfarë, si dhe kur. Kështu që duhet t'ua rikujtosh me shkresë atyre dhe duhet t'i shtosh kërkesës edhe afatin, siç përcaktohet në manual. Përmbajtja dhe raportimi përsëri kërkohen në manual, por duhet vënë theksi tek ajo që tha zoti Balla apo zoti Manja, apo kush e tha, që në të të përfshihet çështja e plotësimit të kërkesave të rezolutës që ka miratuar seanca plenare për to. Kështu që duhet të mbyllet kjo çështje.

Së dyti, lidhur me të dy problemet që u ngritën nga zoti Murrizi dhe dikush tjetër për çështjen e Prokurorit të Përgjithshëm, nuk është normale që një institucion kushtetues apo me ligj të raportojë në më shumë se në një komision. Prokurori i Përgjithshëm do të shkojë te Komisioni i Ligjeve, pastaj Prokurori i Përgjithshëm vjen në seancë plenare ku jemi të gjithë.

Kështu që në të gjitha institucionet të përcaktohet qartë se kush bën çfarë.

Gjithashtu, në lidhje me këtë më sillni një memo çfarë rekomandoni ju për të bërë këto që ngriti zoti Murrizi, që 20% e vendeve të institucioneve të krijuara me ligj janë bosh.

Nuk është vërtetë. Nuk i ka të gjitha presidenti. Vërtet i ka KLSH-ja, të dy, por nuk ka 20%.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Po, ata të dy ka ai, por 18 të tjerët janë këtu. Kështu që duhet ta mbyllim çështjen.

Kalojmë te çështja tjetër: “Miratimi i planit vjetor të veprimit të Kuvendit për zbatimin e rekomandimeve të raportit të progresit të Komisionit European për Shqipërinë”.

Konferenca e Kryetarëve, siç e dini, vjen me ndryshimet e fundit në Rregulloren e Kuvendit dhe e miraton këtë plan veprimi. Planin e veprimit e keni të gjithë përpara. Ai pasqyron gjetjet, rekomandimet dhe sfidat e integruara në progres-raportin e Komisionit European për Shqipërinë.

Për kriterin politik, si dhe për masat konkrete që duhet të merren për realizimin e objektivave të Kuvendit, ku janë përcaktuar 6 objektiva dhe 44 masa, shërbimet përkatëse kanë përgatitur draftin që e keni përpara.

A keni vërejtje apo sugjerime?

Vasilika Hysi - Faleminderit!

Lidhur me planin e veprimit, sikurse shënohet edhe në pikën sqaruese poshtë, i gjithë ky plan duhet të realizohet brenda muajit maj të vitit 2020, kur pritet të publikohet raporti. Duhet të jetë deri në maj të vitit 2020, që do të thotë se ne duhet ta përmbushim këtë plan brenda muajit mars të vitit 2020. Shoh që shumë nga rekomandimet e raportit të vitit 2019 lidhen me punën ose me veprimtarinë e komisioneve, por janë edhe reflektim i ndryshimeve që janë bërë në Rregulloren e Kuvendit.

Prandaj, të nderuar kolegë, zoti Kryetar, dua t’ju them se secili komision ka nevojë të lexojë me vëmendje çdo rekomandim që ka lënë progresraporti, të ketë një kalendar të veprimtarive dhe, të paktën, një herë në dy-tri javë të mbledhjeve së Konferencës së Kryetarëve të raportohet për realizimin, me qëllim që të informojmë institucionet, të cilat janë të pranishme këtu. Ky plan është shumë i rëndësishëm para samitit të Kroacisë. Këtu hyjnë të gjitha detyrat që na janë lënë edhe nga Bundestagu, por edhe nga vetë shtetet e tjera të BE-së.

Faleminderit!

Gramoz Ruçi- Atëherë, edhe unë dua të theksoj, që në qoftë se nuk ka një plan për përmbajtjen, apo për përcaktimin e objektivave dhe të masave konkrete, këto janë detyra shtëpie për çdo komision. Ju lutem shumë, ky plan veprimi të jetë në tryezën e punës së çdo komisioni dhe të caktohen se cilat janë detyrimet e tij dhe, nga ana tjetër, sektori përkatës, që ndjek këtë çështje, realizimin e këtij plani dhe këtyre objektivave, duhet të më informojnë

rregullisht se si, kush, çfarë bën, kush e bëri, kush nuk e bëri, çfarë duhet bërë, çfarë duhet vënë në lëvizje e të tjerë. Dakord?!

Kalojmë te çështja tjetër. Në bazë të nenit 24, pika 2 e Rregullores, janë depozituar dy kërkesa nga deputetët për ngritjen e komisioneve të posaçme parlamentare, që brenda 10 ditëve nga paraqitja e kërkesës duhet të shqyrtohen në Konferencën e Kryetarëve. Besoj se jeni njohur me të dyja kërkesat. Shërbimet e Kuvendit kanë përgatitur një memo për këto çështje, që e keni para. Në bazë të memos është paraqitur kërkesa për ngritjen e komisioneve të posaçme “Për ndërtimin”, pra plotësimin me elemente formale të parashikuara, por jo ato përmbajtësore. Arsytet i keni të parashtruara në memo-n e paraqitur.

Lidhur me kërkesën tjetër, për ngritjen e një komisioni të posaçëm “Për mbikëqyrjen e shpërndarjes së dëmshpërblimeve të ish-të dënuarve politikë të regjimit komunist” shërbimet e Kuvendit janë shprehur se kjo kërkesë i plotëson kërkesat si nga ana formale, ashtu edhe nga përmbajtja, prandaj mbetet në vlerësimin e Konferencës ngritja e një komisioni të posaçëm për këtë çështje, ose caktimi i një grupi deputetësh nga Komisioni i Ligjeve dhe i Ekonomisë për të verifikuar mënyrën e shpërndarjes së dëmshpërblimeve nga Ministria e Financave.

Dua t’ju sqaroj se kërkesa e parë ndryshon nga ajo e dyta, për arsye se në kërkesën e dytë, në ligjin organik që keni bërë për këtë çështje, parlamenti përcakton se duhet ngritur. Ndoshta për t’ju orientuar, në fillim të çdo viti mund të ngremë një grup pune, prej 5 vetash fjala vjen, nga Komisioni i Ligjeve dhe Komisioni i Ekonomisë, ku të jetë edhe i gjithë spektri politik, me qëllim që të prodhojë, vëzhgojë dhe të ketë një raportim për këtë çështje.

Çfarë mendimi ka nga Konferenca?

Fatjona Dhimitri- Faleminderit!

Lidhur me kërkesën e një grupi deputetësh për ngritjen e komisionit të posaçëm “Për ndërtimin” besoj se të gjithë e kemi para memon dhe jemi njohur me të, ku sipas së cilës thuhet se ngritja e një komisioni të posaçëm “Për ndërtimin” bie ndesh ose do të dublonte veprimtarinë apo rregullat e Komisionit të përhershëm të Veprimtarisë Prodhuese. Nuk besoj se kemi një konflikt për sa i përket veprimtarisë së dy komisioneve, pasi te kërkesa për ngritjen e komisionit të posaçëm “Për ndërtimin” objekti i kësaj kërkesë është tërësisht i kufizuar, në të cilën kërkohet që të forcohet edhe më shumë ligjshmëria në fushën inxhiniero-teknike të ndërtimit. Pra, objekt i këtij komisioni nuk është që të kontrollojë veprimtarinë e Ministrisë së Ndërtimit, por të bashkëpunojë me të për të forcuar edhe më tej rregullat në fushën inxhiniero-teknike, të cilat besoj se u shfaqën apo dolën në pah më tepër nga ajo që shkaktoi tërmeti i 26 nëntorit.

Pra, nuk besoj se kemi një dublim të veprimtarisë së dy komisioneve, në rast se do të ngrihet një komision i posaçëm për ndërtimin.

Faleminderit!

Taulant Balla – Ky nuk është një diskutim që zhvillohet për herë të parë në Kuvend. Shumë herë ka pasur propozime dhe këtu vihet në pah dallimi mes komisionit të përhershëm dhe komisionit të posaçëm. Arsyeja që historikisht Kuvendi ka bërë, Konferenca e Kryetarëve, i cili është autoriteti i vetëm për ta shqyrtuar, është që në momentin kur një propozim për një komision të posaçëm mbivendoset mbi kompetencat e komisionit të përhershëm, prevalon komisioni i përhershëm. Në rast se ne do t'i jepnim rrugë kësaj iniciative, të jeni të sigurt që Kuvendi i Shqipërisë do të përfundonte me 100 komisione të posaçme, ku secili deputet do të merrte iniciativën për të krijuar një komision të posaçëm dhe ta drejtonte vetë atë komision të posaçëm. Merreni dhe lexojeni kërkesën e deputetëve. Më thoni cila nga pikat e kërkesës së deputetëve të respektuar, Artur Roshi, Myslim Murri e të tjerë me radhë, nuk hyn në kompetencat e komisionit. A dëshironi të keni një projektligj të ri për ndërtimin?! Jeni të mirëpritur, do të caktohen nga Konferenca e Kryetarëve komisionet përkatëse dhe nuk do të jetë vetëm Komisioni i Veprimtarive Prodhuese, por do të jenë disa komisione që do ta shqyrtojnë. Doni të përafrojmë eurokodet?! Patjetër që duhen bërë, biem shumë dakord, por, ju lutem, nuk është rasti i tërmetit për të marrë nisma personale. Këtu jemi në një situatë që ne duhet të respektojmë Rregulloren. Fakti që bie ndesh me kompetencat e Komisionit të Veprimtarive Prodhuese, i cili është komisioni, që mbulon këtë sektor, na bën që brenda këtij komisioni në mënyrë të menjëhershme deputetët e opozitës dhe të maxhorancës të fillojnë punën për t'i adresuar çështjet që keni adresuar me kërkesë.

Te kërkesa e dytë (po është e vërtetë), bie tërësisht dakord me atë që tha Kryetari i Kuvendit, që në formë kërkesa është shumë e rëndësishme, sepse prej 12 vjetësh, që nga viti 2007, kur është bërë parashikimi në ligj, nuk është bërë një raportim i tillë në fillim të vitit. Por kur kjo është përcaktuar në ligj, ligji nuk ka thënë ngritjen e një komisioni të posaçëm, por ligji ka kërkuar domosdoshmërisht raportimin në Kuvend. Unë, pa humbur kohë, si shumë nga ata që kanë brenda familjeve të tyre njerëz, të cilët kanë vuajtur në kohën e komunizmit, them që kjo të përfshihet si një detyrë e posaçme tek të dyja komisionet. Kjo do t'i jepte më shumë peshë dhe do të kursenim sa më shumë kohë. Këtë duhet ta bëjmë në mënyrë të menjëhershme, deri në ngritjen e komisionit. Më pas do të shohim nëse kemi mundësi, kapacitete për t'i mbështetur me këshilltarë, zyra, sekretarë e të tjera me radhë. Nga eksperiencia mendoj se ngritja e menjëhershme, me urdhër, vendim të Konferencës së Kryetarëve të një grupi pune

mes dy komisioneve, do të na jepte një raport të menjëhershëm për situatën e dëmshpërblimit të familjarëve, pasardhësve apo, falë Zotit, ata që janë ende gjallë, se në çfarë niveli dëmshpërblimi jemi deri tani.

Faleminderit!

Myslim Murrizi - Për pjesën e kërkesës së parë, atë që shikoj nga memoja e dërguar nga punonjësit e Kuvendit, është se deputetët mund të kërkojnë që të thërrasin në interpelancë ministrin përgjegjës; nëse e çmojnë të domosdoshme, mund të bëjnë propozime dhe kjo ndodh për të gjitha komisionet e posaçme që janë krijuar në këtë Kuvend nga 31 marsi i vitit 1991 dhe deri tani. Gjithsesi, mos e ngatërmoni punën e komisionit që ka kërkuar zoti Roshi. Edhe unë si firmëtar nuk është se kam lexuar me detaje se çfarë kërkohet, mos e gjykoni se po ju hyjmë pjesë në tenderë, ore burri i dheut. Nuk ka asnjë lloj problemi, nuk e duam atë komision, vazhdojeni me ministrin e tërmetit, bëjini tenderë, se ndoshta kujtoni se jemi aksionarë. Po që të më thuash mua nuk e lejon ligji atë komision për të kërkuar llogari për dëmshpërblimet e të përndjekurve... Ta lejon ligji dhe në nenin 17, thuhet: “Kuvendi çdo tremujor të parë ngre një komision të posaçëm”.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Ti thua jo do t’u çojmë ne shkresë që të na raportojnë këtu ata. Çfarë kostoje ka komisioni i posaçëm për të parë dëmshpërblimet e të përndjekurve? Radhën se si bëhet; cila jepet...

Taulant Balla – Nuk më kuptove.

Myslim Murrizi - Si nuk të kuptova?! A je dakord për ngritjen e komisionit të dytë?

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Si nga të dy? Një komision të posaçëm thotë ligji.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Gramoz Ruçi – Komision të posaçëm me pjesëmarrjen e deputetëve Maliqi dhe...

Myslim Murrizi - A jeni dakord për ngritjen e komisionit të dytë? Atëherë, dakord. Sepse këtu shikoj që thonë: meqenëse nuk është ngritur në vitin 2007, mos e ngremë as ne.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Në rregull, për të parin rrini pa merak, i thoni ministrit të tërmetit që nuk po krijojmë komisionin.

Fatjona Dhimitri - Zoti Balla, për ngritjen e komisionit të posaçëm për ndërtimin, besoj se në Komisionin e Veprimtarisë Prodhuese nuk ka inxhinier ndërtimi që mund të japë një shpjegim specifik në lidhje me...

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Prandaj po them: ngritja e një komisioni të posaçëm për përcaktimin e një bazamenti të Përhershëm për Vendosjen e rregullave të përhershme në fushën e ndërtimit do të mund ta shpallte më pas nevojën për të bërë gjithmonë ligje sa herë ne përballemi me fatkeqësi të tilla natyrore.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Ju e dini përbërjen e komisioneve, zoti Kryetar!

Gramoz Ruçi – Lidhur me çështjen e parë, së pari, unë kam vënë shënimin atje që nuk duhet të kemi dublime me komisione të posaçme kur kemi komisionet *ad-hoc* të parlamentit. Sa herë që kërkohet të bëhen të tilla, është ose spekulim, ose komisioni përkatës nuk e bën detyrën. Dhe ja ku jemi, ta themi.

E dyta, ju lutem shumë, të mos e shikojmë situatën kaq të lehtë që do të ngremë ne një komision dhe qëllimi i ngritjes së këtij komisioni është bërja e eurokodeve; një fjalë goje është. E kuptoni ju se ku jemi me situatën? E kam thënë kur ra tërmeti, do ta them edhe sot: një nga objektivat e këtij sesioni parlamentar është që ne t'i futemi fushës së përmirësimit të ligjeve dhe të kodeve përkatës.

Unë, si Kryetar i Kuvendit, i jam futur kësaj pune dhe më rezulton se Shqipëria po punon me eurokodet e sistemit të kaluar, ato të vitit 1989. Qartë? Askush të mos mendojë këtu se ka aftësinë dhe zotësinë që mund të marrë penën e lapsin dhe të bëjë eurokode. Por që këtë punë do ta bëjmë ne, kjo nuk diskutohet.

Kam ftuar në një takim profesorin nga Selaniku që merret me këtë çështje dhe konkluzioni i tij ishte ky: Italia, Shqipëria dhe Greqia janë në të njëjtën zonë sizmike. Italia dhe Greqia kanë pasur të njëjtën vështirësi që keni ju, por ne kemi bërë përmirësime ligjore dhe eurokode të reja. Ju duhet t'i merrni legjislacionin dhe këto eurokode dhe në kushtet shqiptare t'i adaptoni për t'i miratuar. Ndaj ne si Kuvend duhet të vazhdojmë të marrim nga homologët tanë grekë dhe italianë të gjithë praktikën e tyre për këtë çështje dhe ta përkthejmë. Në qoftë se qeveria nuk e bën këtë punë (mirë është ta bëjë qeveria dhe ta sjellë këtu), ne duhet të marrim iniciativën, si deputetë, dhe të angazhojmë ekspertë nga të gjitha fushat. Ky do të ishte shërbimi më i mirë i kësaj legjislature parlamentare, në qoftë se ne arrijmë dhe bëjmë adaptimin, pra legjislacionin e ri dhe kodet e reja për të mos ndryshuar ligjet e natyrës, por për të parandaluar dëmet që bën ligësia natyrore, siç janë tërmetet ose zjarret, uji apo ku di unë se çfarë. Pra, ta shikojmë kështu këtë punë.

Për sa i përket çështjes së dytë, siç edhe ramë dakord (se problemi nuk është që ka ose

jo vullnet e njëren, tjetren, si ta bëjmë më mirë, kjo është ligjore), të ngrihet komisioni me katër-pesë veta menjëherë, me një vendim të Konferencës së Kryetarëve, nga Komisioni i Ligjeve dhe ai i Ekonomisë, t'i caktohet edhe një afat që të sjellë informacionin përkatës lidhur me dëshmipërblimet sipas ligjit organik që është bërë për këtë çështje.

E mbyllëm edhe këtë.

Në përfundim, dua t'ju njoftoj për ecurinë e punës së projektit “Për mbështetjen e Kuvendit për edukimin qytetar”. Qeveria shqiptare në qershor të vitit 2019 ka nënshkruar me Agjencinë Zvicerane për Zhvillim dhe me OSBE-në një marrëveshje për zhvillimin e projektit që financohet nga qeveria zvicerane dhe që po zbatohet nga OSBE-ja dhe nga Instituti Demokratik Kombëtar. Përfituesi kryesor i këtij projekti katërvjeçar është Kuvendi i Shqipërisë dhe qytetarët shqiptarë. Dua t'ju informoj se administrata e Kuvendit, si dhe disa komisione parlamentare, së bashku me partnerët, kanë filluar zbatimin e këtij projekti, i cili ka për qëllim forcimin e Kuvendit për kryerjen e funksioneve legjislative, mbikëqyrëse dhe përfaqësuese në mënyrë sa më efikase.

Deri tani kanë marrë udhë për zhvillim disa aktivitete mjaft të rëndësishme që do të kenë ndikim të drejtpërdrejtë në përmirësimin dhe në rritjen e efektivitetit të veprimtarisë së Kuvendit. Kështu, ka filluar puna për hartimin e një plani strategjik për Kuvendin e Shqipërisë, i cili do të jetë një dokument, ku do të përcaktohet vizioni dhe njëherazi misioni i Kuvendit, fushat prioritare, qëllimet dhe objektivat strategjike, që Kuvendi dhe administrata e tij do t'i vendosin vetes për ta bërë atë realitet.

Grupi i punës për hartimin e këtij plani strategjik ka pasur në vazhdimësi mbështetjen dhe ekspertizën vendase dhe ndërkombëtare nëpërmjet OSBE-së dhe Institutit Demokratik Amerikan për të prodhuar një dokument sa më të mirë dhe që pasqyron kërkesat reale nga Kuvendi, si dhe mënyrat për arritjen e tyre. Shumë shpejt të gjitha grupet parlamentare dhe deputetët do të kenë në dorë draftin final për të dhënë vlerësimet dhe kontributin e tyre për përmirësimin e këtij dokumenti strategjik, i cili, krahas konsultimit të brendshëm të kryer, do t'i nënshtrohet edhe një konsultimi të jashtëm.

Një tjetër aktivitet shumë i rëndësishëm, që do të ketë impakt të drejtpërdrejtë në punën e komisioneve parlamentare, është fillimi i punës për hartimin e manualit për veprimtarinë kontrolluese dhe mbikëqyrëse të Kuvendit të Shqipërisë, i cili po hartohet në bashkëpunim dhe me mbështetjen e shërbimeve parlamentare zvicerane dhe me praktikën e tyre më të mira. Qëllimi i këtij manuali është të rrisë ndërgjegjësimin e parlamentarëve për funksionin kontrollues dhe mbikëqyrës të Kuvendit, t'i ndihmojë ata të kuptojnë procedurat që duhet të

ndjekin komisionet, nënkomisionet parlamentare dhe seancat plenare në këtë drejtim, si dhe të adresojë ndryshimet më të fundit që kemi miratuar në Rregulloren e Kuvendit për kontrollin dhe mbikëqyrjen parlamentare.

Aktiviteti tjetër që dua të njoftoj është se ka filluar të zbatohet dhe është në fillim të punës krijimi i një sistemi legjislativ të integruar dhe transparent, që do të përmirësojë dhe lehtësojë aksesin e ligjeve të konsoliduara dhe të dhënat parlamentare. Kjo do të realizohet nëpërmjet krijimit dhe përdorimit nga deputetët dhe mandej nga publiku të një sistemi të integruar që, i përshtatur, do të sigurojë mbështetje për konsolidimin e legjislacionit, do të sigurojë dixhitalizimin e të dhënave të shkuara parlamentare, si dhe integrimin e tyre në sistem. Ky proces do të jetë një nga objektivat strategjike që do t'i shërbejë rritjes së transparencës së veprimtarisë së Kuvendit.

E fundit, por jo më pak e rëndësishme, në kuadër të projektit të PACEP-it u bë shkëmbimi i eksperiencave konkrete të kryetarëve të disa komisioneve parlamentare me praktikantët e punës së komisioneve parlamentare të Bundestagut gjerman, ku u vendos se do të ishte e vlefshme dhe dobiprurëse bashkëpunimi i mëtejshëm dhe unifikimi i praktikave të punës së komisioneve parlamentare mbi bazën e një manuali orientues dhe të detajuar. Së shpejti do të fillojë puna për draftimin e tij.

Këto ishin çështjet për këtë mbledhje.

Dua t'ju kujtoj edhe një herë se seanca e ditës së sotme do të hapet në orën 17:00. Kjo do të jetë seanca e hapjes së sesionit të ri parlamentar. Janë të lutur drejtuesit e grupeve parlamentare, nëse dëshirojnë, të diskutojnë deri në dhjetë minuta për hapjen e sesionit të ri parlamentar.

Së dyti, dua t'ju kujtoj për nesër zhvillimin e tri aktiviteteve për 100-vjetorin e parlamentarizmit, të cilat do të vazhdojnë edhe në ditët, javët dhe muajt që vijnë, pasi ky do të jetë viti i parlamentarizmit shqiptar. Nesër do të përkujtojmë në Lushnjë në orën 09:30 Kongresin e Lushnjës, kurse në orën 11:30 do të kemi hapjen e ekspozitës “100 vjet parlamentarizëm”, në krahun anësor të Rognerit. Më pas, po në të njëjtin ambient, do të zhvillohet sesioni jubilar ose sesioni shkencor për ...

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Po, po Pallati i Kongreseve.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Jo, jo, hyrja nga Rogneri.

Të gjithë deputetëve u është dërguar ftesë, megjithatë ju lutem të gjitha grupeve

parlamentare të jenë prezente! Sigurisht që nuk do të vijnë të gjithë në Lushnjë. Unë dhe zoti Murrizi do të jemi atje, të tjerët të vijnë sipas mundësive, por duhet të sigurohemi për të dy aktivitetet që do të zhvillohen në Pallatin e Kongreseve.

E fundit, meqë këtu janë të gjithë kryetarët e komisioneve, por edhe shërbimi, për sa i përket transparencës, është e patolerueshme që 40% e aktivitetit të komisioneve parlamentare nuk janë bërë publike. Kjo është vërejtje për shërbimet, por edhe për ju si drejtues komisionesh.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Është reale, nuk është problemi se është atje. Kësaj pyetjeje ne duhet t'i japim përgjigje. Prandaj, sekretarët, këshilltarët e komisioneve, kush e ka këtë përgjegjësi, do të shkojnë deri në largim nga puna nëse nuk përmbushin detyrën. Kryetarët e komisioneve të thërrasin menjëherë stafin e komisioneve, sepse nuk ka asnjë arsye të përligjur që të mos bëhen publike procesverbalet e mbledhjeve së komisioneve. Qartë!?

Punë të mbarë!

MBLEDHJA MBYLLET

KRYETARI

Gramoz RUÇI

Sekretare
Ermira Koka

Përgjegjëse e Sektorit të Redaktorëve
Euzheni Pengili